

Të nderuar qytetarë,

5Është çudi e madhe të shikosh një sundimtar të mplakur, i cili nuk e kupton se durimi i popullit është vorba ku ai ha vetveten. Po kaq bezdi t'ia dëgjosh fjalimet e gjata, me gjuhë matrapazësh, rënkim pagjumësie, të njohura, tejet të njohura, të zvetënuara, tejet të zvetënuara, me ritmin e kollës së njomë. Një gjë e mirë nuk i ka braktisur ende shqiptarët, ajo mban emrin e asaj pjese të madhe të shoqërisë, e cila nuk e ul kokën e as sytë përdhe, e cila e përbuz frikën, e cila nuk dëshiron t'ia dorëzojë vendin një bande dhe një banditi.

Në tregun e poshtërsisë njerëzore, në brazdat e banalitetit, në hojet e ndyra të vesit, kjo urdi, ky sekt, këta surratçerëpë, që masakruan zgjedhjet dhe vullnetin popullor për të shtuar eurot, vilat, llogaritë bankare, tenderët, korrupsionin dhe sundimin, shfaqen besimplotë se bashkë me 25 prillin mund të vrasin edhe kujtesën dhe ndërgjegjen e qytetarëve të këtij vendi. Në turravrapin e natës hajdutët e votës besuan që drita e dialektikës historike nuk do të bjerë kurrë mbi ta, megjithëse ua pamë fytyrat, të shëmtuara, me vragat e shëmtisë, ua shënuam emrat në Zadrimë, Torovicë, Shëngjin, Shënkoll, Lezhë, Mirditë, Kurbin e kudo nëpër Shqipëri. Një ditë, jo larg, drejtësia do të rivendoset, do të dalë nga kllapia, për t'i futur të gjithë në kllapat e saj, frotën, larot, shakllabanat, matrahulat e kryemataret, këto rrista te ndyta në trupin e shtetit të marrë peng. Nga kjo foltore dua t'u bëj homazh dhe të përkulem në shenjë nderimi para të gjithë atyre që nuk u shitën e nuk u blenë, që pështynë mbi kërcënimet e parave të drogës kudo në territorin e Republikës, por sidomos ndaj banorëve të Lezhës, Mirditës e Kurbin, kësaj popullsie qendrestare e rezistente në shekuj për identitet e autenticitet, për shtetformim e demokraci, e cila nuk e dorëzoi fitoren e vet.

Shqipëria e ka në sy portretin e hajdutit, i cili mendon se u bë mbret, të bracave që ndihen princër, të kriminelëve që shfaqen si zotërinj oxhaku, e që kanë një emër: Kryeministër, ministra, deputetë, kryetarë bashkie, çirakë të të gjitha ngjyrave, pengmarrës të ndryshimit, konservues të frikës dhe pasurisë së tyre. Shqipëria do të reagojë, ajo do të rezistojë, ajo do të përballet-shënojeni këtë ju që zgërdhieni- ,ajo e refuzon vdekjen e së ardhmes dhe ngjyrën e zezë të horizontit për fëmijët e vet, ajo e përbuz segregacionin politik. Opozita e Shqipërisë, Partia Demokratike, në emër të paqes së përjetshme të martirëve, në emër të të gjallëve të kësaj toke, e konsideron këtë qëndrim një detyrë të shenjtë, shmangia nga e cila meriton çdo mallkim burri dhe gruaje, biri e bije, të çdokujt që beson ende se emri shqiptar i jep nder. Broshurën, e cila fyen çdo program duke i vjedhur emrin konceptit, e lexova i bindur se çfarë do gjeja. Dhe çfarë gjeta? Një përçartje pompoze fjalish, produkt i stomakëve prej llastiku, mendjeve të thara, të fytyrave që nuk skuqen e as nuk zverdhen. Edhe pse na vunë në dorë një asgjë të quajtur "Programi i qeverisë", vendosa ta përsërisja me vargjet e Lasgushit: "Nga ferra doli një lepur, i ra xha Zyku dhe e la te vdekur". Ky program që nuk është program fillon me qyfyre të tipit "qeveria nuk është zanat, por mandat i deleguar nga populli". Kjo maksimë e liderit qenkësh leva e Arkimedit, e cila çon realitetin drejt havasë dhe mbaron me urra, si në filmat e kinostudios "gati për Shqipërinë" "hic jemudum, o burra bre dudum". Fraza bombastike, patetike, naive, shëtisin në liridalje absolute, si ushtarë çakërrqejf, të dalë nga mejhana e periferisë, në të gjithë atë surrogato tekst apo manifest gënjeshtarësh, dokrra pa kokrra. Përsëritje të programit të vitit 2009, 2013, me enciklika papale të tepsisë e timonit të vitit 2017, si një masë veshtullore petullash pa ujë,

tundur me arrogancë e përtesë të një shëndetligu që quhet Kryeministër, të cilit injoranca e krenaria i rrinë bashke si shtati e hija.

Programi për arsimin flet për shkolla të reja ndonëse 1/3 e tyre janë rrezik për shëndetin, 50% e tyre nuk kanë ujë të pijshëm, në tetë vjet nuk është bërë asnjë investim substancial për laboratorët, por programi nuk na thotë sa mijëra fëmijë e kanë braktisur Shqipërinë dhe kush i dëboi ata. Na mburret se për arsimin parauniversitar do të japin tekste falas (një iniciative e hershme e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike), dhe se do të zhvillojnë arsimin profesional, ose do të lexojmë librin "Kurbani". Ku janë rezultatet e PISA-s, raporti i së cilës na thotë se analfabetizmi funksional në arsimin 9-vjeçar është 53% dhe pas pandemisë shkoi në 60%, sa ka rënë Shqipëria dhe pse. Asnjë të dhënë nuk ka për rritjen e buxhetit për sistemin universitar. Asgjë për grevat e studentëve dhe ligjin e arsimit të lartë, këtë përmendore marrëzie e politizimi të bërë nga kopshtarët e universiteteve të Europës. Asgjë për teknologjinë në arsim, sjelljen në epokën e re, asgjë për dështimin e arsimit gjatë pandemisë që vazhdon ende. Librat digjitalë kurrë nuk u përdorën dhe nxënësit nuk u ndihmuan për ta bërë mësimin online, pa pajisje, pa internet, përjashto kronikat e mediave të propagandës, plot ojna, lot e thagma e përqafile. Mësuesit u lanë në mëshirë të fatit për të kryer të gjitha detyrat me nxënësit dhe pa asnjë mbështetje financiare. Shkruhet për internacionalizëm të universiteteve tona, por nuk thuhet sa është shuma e vënë në dispozicion, kush do ta përballojë një dokërr, një gënjeshtër, një qyfyre. Pra, kemi një pankartë të madhe bosh nga brenda fasadë për të fshehur dështimin e ligjit të arsimit të lartë. Sa lekë u dhanë për mbështetjen e kërkimit shkencor në Shqipëri, për bibliotekat e shkollave dhe të universiteteve? A di kush në këtë sallë që të na e shuajë kuriozitetin? Kryetari i Akademisë së Shkencave, një bolshevik ekstremist senil, emërohet me puç kushtetues në krye të institucionit, duke e kthyer përfundimisht atë në akçihane ideologjike, në zonë nën mediokritet, ku livrohen ca fonde, ca alokime për riparjen e historisë për të rehabilituar krimet e komunizmit. Aty punësohen pensionistët e Partisë Socialiste, Caci, pse jo, edhe shoku Gramoz, më vonë akademikët, si Ahmetaj, si Ulsi Manja, zoti Gjijnuri e plot akademikë të tjerë që përgatiten. Peleshi nuk besoj se ka interes, se merret me biznes. Pas këtij përshkrimi mund të arrijmë në disa konkluzione: buxheti nuk garanton një sistem arsimor funksional dhe cilësor, premtimi ka qenë 5% e GDP-së, ndërsa ai aktual është 2,55%; qeveria nuk ka vullnet dhe as vizion për statusin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore; infrastruktura fizike e shumë objekteve arsimore publike nuk garanton cilësi dhe shpesh është e dëmshme për shëndetin; sistemi arsimor është thellësisht diskriminues për nxënësit dhe studentët e varfër.

Atëherë, duke përfunduar, ju kujtoj thënien e presidentit partizan Sandro Pertini, i cili u pati lënë amanet qytetarëve të tij: "Kur një qeveri nuk bën atë çfarë do populli, ajo duhet larguar edhe me hunj e gurë"! Në rastin më të mirë do të keni fatin e sulltan Abdyl Hamitit, i cili u largua me një karrocë i veshur tebdil si firaun, nëse këta hunj nuk do të hyjnë ndokund në rrotat e saj. Faleminderit!